

Udhëzime të rëndësishme

Për shkak të një lexueshmërie më të mirë do të hiqet dorë nga përdorimi i emërtimeve të gjinisë femërore dhe mashkullore. Në rast se do të përdoren emërtime të gjinisë asnjane ose mashkullore, me këto do të nënkuptohen gjithashtu dhe personat femërorë dhe mashkulorë.

Si pasojë e kontroleve për arsye sigurimi, mund të ketë vonesa gjatë hyrjes në institucionin e gjykatës. Ndaj ju lutemi mbajeni parasysh këtë gjatë udhëtimit tuaj.

Mjediset e brendshme në gjykata nuk janë të gjitha pa barrierë. Nëse ju keni nevojë demostoshmërisht për një akses hyrjeje pa barrierë informohuni ju lutem paraprakisht pranë gjykatës mbi mundësitë lokale të aksesit hyrës.

1. Si dëshmitar ju përmbushni një detyrë të rëndësishme si shtetas. Me deklaratën tuaj, ju në rrethana të caktuara kontribuoni në një masë të konsiderueshme për një vendim të drejtë të gjykatës. Edhe nëse mendoni, që nuk keni shumë për të deklaruar, paraqitja juaj është e nevojshme për gjetjen e së vërtetës. Nëse posedoni shënime dhe dokumente të tjera, të cilat ju lehtësojnë përgjigjen e pyetjeve të provës, ju lutemi, silleni këto me vete në takimin e caktuar. Paraqitja juaj është e nevojshme edhe atëherë, nëse keni dhënë tashme një herë deklaratë në këtë çështje.

Më shumë informacione i gjeni në fletën udhëzuese për dëshmitarë "Zeugen gesucht!" ("Kërkohen dëshmitarë!"), të cilën mund ta shkarkoni në internet tek <http://www.mj.niedersachsen.de>.

2. Një dëshmitari, i cili nuk paraqitet në takimin e caktuar pa pasur një ndjesë të mjaftueshme, i ngarkohen shpenzimet e shkaktuara nga mosparaqitja e tij. Njëkohësisht caktohet kundër tij një gjobë disiplinore deri me 1.000 Euro dhe për rastin, që kjo nuk mund të arkëtohet, caktohet kundër tij burgimi disiplinor deri në gjashtë javë. Në rrethana të caktuara, edhe një paraqitje e detyruar me forcë mund të urdhërohet.
3. Ndjesën e mjaftueshme dëshmitari e ka vetëm atëherë, nëse ai nuk mund të vijë në takimin e caktuar për një arsye të rëndësishme (p.sh. për shkak të një sëmurjeje të rëndë). Nëse mendoni, që nuk mund ta zbatoni thirrjen për një arsye të tillë të rëndësishme, ju lutemi njoftoni për këtë menjëherë duke e deklaruar arsyen e pengesës. Arsyja e mosparaqitjes suaj duhet të bëhet e besueshme përmes një vërtetimi mjekësor ose përmes një vërtetimi tjetër. Një **vërtetim paafëtësie pune nuk mjafton**. Nga vërtetimi mjekësor duhet të dalë, që ju jeni **të paafëtë për t'u paraqitur në gjyq dhe për të udhëtuar**. Atëherë gjykata do ta shqyrtojë parashtrimin tuaj. Megjithatë, derisa ju nuk merrni një njoftim me një përmbajtje tjetër, kjo thirrje mbetet e vlefshme.
4. Ju lutemi, njoftoni **menjëherë** pas marrjes së thirrjes, nëse ekzistojnë rrethana, të cilat e ngarkojnë paraqitjen tuaj **me shpenzime të jashtëzakonshme**. Një rast i tillë për shembull mund të ekzistonte, nëse përmes zbatimit të takimit të caktuar, një udhëtim pushimi i prenotuar fiks nuk mund të nisej dhe nëse për shkak të tërheqjes, shpenzime të mëdha do të shkaktoheshin. Nëse për shkak të punës suaj të pavarur do të shkaktoheshin shpenzime zëvendësimi ose një humbje të ardhurash, e cila zgjat për disa ditë, ju lutemi gjithashtu ta njoftoni gjykatën **menjëherë** për këto rrethana, duke bashkëngjitur vërtetime përkatëse.
5. **Ju lutemi, njoftoni edhe menjëherë, nëse planifikoni të nisni udhëtimin nga një vend tjetër se nga vendi i përmendur në fletën e thirrjes, nga që përndryshe mund të shkaktoheshin për ju disfavore në caktimin e shpërblimit, i cili juve ju takon.**

6. Ju lutemi, njoftoni gjithashtu menjëherë për ndryshime të mundshme në adresën tuaj, kështu që ju mbeteni të arritshëm në çdo kohë.
7. Pas parashtrimit të një kërkesë, në kuadër të dispozitave të Ligjit të Pagesave dhe të Shpërblimeve Juridike (Justizvergütungs- und -entschädigungsgesetz) ju merrni një shpërblim për humbje të ardhurash, për disfavore në mbajtjen ekonomisë familjare, për humbje kohe dhe shpenzime si dhe një zëvendësim për pagesa të kostove të udhëtimit dhe për shpenzime të tjera.

Pretendimi juaj për shpërblim shuhet, nëse ai nuk kërkohet brenda **tre muajve** pas përfundimit të thirrjes si dëshmitar gojarisht ose me shkrim pranë kancelarisë së gjykatës së shënuar në fletën e thirrjes. Në rastin e përfundimit të parakohshëm të thirrjes, afati fillon me njoftimin tuaj për kryerjen e detyrës. Nëse jeni thirrur disa herë në një shkallë procesi, përcaktuese për fillimin e të gjitha afateve është thirrja e fundit në këtë shkallë procesi.

8. Lartësia e humbjes së të ardhurave duhet vërtetuar përmes vërtetimeve. Punëmarrës duhet ta parashtrorjë një vërtetim të punëdhënësit për pagën rregullore bruto (edhe në rastin e një page mujore), për numrin e orëve rregullore të punës çdo ditë, për orarin e fillimit dhe të mbarimit të punës çdo ditë si dhe për faktin, nëse humbja e pagës shtrihet vetëm në kohën e punës së humbur përmes zbatimit të takimit të caktuar ose edhe në kohëra më përpara dhe më pas. Bashkëngjitur gjeni një formular për vërtetimin përkatës.

Punonjës të pavarur, anëtarë të profesioneve të lira etj. duhet të parashtrorjë dokumente të tjera përkatëse (p.sh. faturën e pagesave për një zëvendësim të nevojshëm në biznes, regjistrimin e biznesit, regjistrimin si usta).

Shpërblehen të ardhurat rregullore bruto të humbura, përfshirë pagesat për sigurimin shoqëror, të cilat duhen bartur nga punëdhënësi, për gjithë kohën e thirrjes, por jo për më shumë se dhjetë orë në ditë dhe maksimalisht 21 Euro për orën.

9. Pagesa zëvendësohen vetëm atëherë, nëse ato vërtetohen përmes vërtetimeve (p.sh. bileta të mjeteve të transportit publik të përdorura, faturë për pagesën e një përkujdesjeje për fëmijë të vegjël).

Në rastin e përdorimit të një mjetit të transportit publik, i cili qarkullon rregullisht, juve ju shpërblehen pagesat e shkaktuara realisht sipas përcaktimeve ligjore.

Në rastin e përdorimit të një mjete motorik të vet ose të lënë falas për përdorim, do të shpërblehen 0,25 Euro për çdo kilometër të udhëtuar plus pagesat në të holla të shkaktuara (veçanërisht pagesa parkimi). Në rastin e përdorimit të mjeteve të tjera motorike do të shpërblehen pagesat e shkaktuara realisht deri në shumën e shpenzimeve në rastin e përdorimit të një mjete motorik të vet plus pagesat në të holla të shkaktuara.

Shpenzime më të larta udhëtimi do të shpërblehen, nëse përmes këtij shpërblimi do të kursehen shuma më të larta shpërblimi ose nëse këto janë të nevojshme për shkak të rrethanave të veçanta.

Pagesa, të cilat mund të shmangeshin, nuk do të shpërblehen.

10. Nëse parashkohet, që juve mund të shkaktoheshin shpenzime udhëtimi ose shpenzime të tjera të konsiderueshme, atëherë, pas parashtrimit të një kërkesë, juve mund t'ju jepet një parapagesë e shpërblimit të udhëtimit.

Këtë kërkesë ju mund ta parashtroni pranë gjykatës së shënuar në krye të letrës, në raste urgjente edhe pranë gjykatës së shkallës së parë përgjegjëse për vendqëndrimin tuaj. Ju lutemi, parashtroni kërkesën menjëherë pas marrjes së kësaj thirrjeje.

11. Pranë disa gjykatave ekziston mundësia e përkujdesjes për dëshmitarët para dhe pas marrjes në pyetje. Nga që këto institucione nuk ekzistojnë pranë të gjitha gjykatave, rekomandohet, që të kërkohen informacione rreth ekzistencës së një institucioni të tillë pranë gjykatës së shënuar në fletën e thirrjes.

□ **Udhëzime për të plagosur dhe/ose paditës dytësorë:**

Për të plagosurit në çështje gjobë vlejné vetëm shifrat vijuese 13., 18., dhe 19.

12. Pas parashtrimit të një kërkesë, të plagosurit njoftohen - përderisa u takon atyre - për pezullimin e procedurës, për vendin dhe kohën e seancës kryesore si dhe për akuzimet e ngritura kundër të pandehurit si dhe për rezultatin e procedurës gjyqësore. Në veçanti të plagosur mund të parashtrojnë një kërkesë, që të njoftohen, nëse të dënuarit i është dhënë urdhri, të mos kërkojë kontakt me të plagosurin ose të mos të ketë hyrje-dalje me të plagosurin. Nëse i plagosuri nuk zoton gjuhën gjermane, ai mund të njoftohet, pas parashtrimit të një kërkesë, për vendin dhe kohën e seancës kryesore në një gjuhë të kuptueshme për atë.

Veç kësaj, pas parashtrimit të një kërkesë, i plagosuri njoftohet, nëse kundër të akuzuarit ose të dënuarit janë urdhëruar ose përfunduar masa me heqje lirie ose nëse atij, për herë të parë respektivisht sërish, i jepen lehtësime në ekzekutimin e dënimit ose pushime, në qoftë se paraqitet një interes i përligjur dhe nëse atij nuk i rri përkundër ndonjë interes i të prekurit, i cili duhet mbrojtur (neni 406d Kodi i Procedurës Penale (StPO)). Në raste të veçanta të përcaktuara me ligj, nuk ka nevojë për paraqitjen e një interesi të përligjur. Veç kësaj, pas parashtrimit të një kërkesë, i plagosuri njoftohet edhe, nëse i akuzuari ose i dënuari i është shmangur një mase me heqje lirie përmes arratisjes dhe çfarë masash për mbrojtjen e të plagosurit eventualisht janë marrë nga kjo arsye.

Ju lutemi vini re, që njoftimet edhe të mund të mos përcillen, nëse nuk janë të mundshme nën adresën e deklaruar.

Nëse i plagosuri ka zgjedhur një avokat në mbështetjen e tij, nëse një i tillë i është bashkëngjitur atij me urdhër ose nëse i plagosuri përfaqësohet nga një avokat, njoftimet i dërgohen këtij.

13. Nëse ekziston një interes i përligjur, i plagosuri ka të drejtë të kërkojë nëpërmjet një avokati këqyrjen e dosjeve ose kopje të veçanta nga dosjet si dhe të këqyrë prova fizike të ruajtura zyrtarisht, përderisa atij nuk i rrinë përkundër interesa mbizotëruese të të akuzuarit ose të personave të tjerë, të cilët duhen mbrojtur (neni 406e StPO (Kodi i Procedurës Penale i Gjermanisë)).
14. I plagosuri ka të drejtë, që me shpenzimet e veta të shfrytëzojë ndihmën e një avokati mbështetës, i cili është i pranishëm gjatë marrjes në pyetje dhe i cili mund të ushtrojë të drejta të veçanta për të plagosurin.

Gjithashtu, pas parashtrimit të një kërkesë të tij, gjatë marrjes në pyetje të të plagosurit si dëshmitar mund të jetë i pranishëm një person, në të cilin ai ka besim, vetëm atëherë jo, nëse nëpërmjet kësaj synimi i shqyrtimit do të rrezikohej (neni 406f StPO (Kodi i Procedurës Penale i Gjermanisë)).

15. Sipas nenit 395 StPO (Kodi i Procedurës Penale i Gjermanisë), persona me të drejtën e bashkimit me anë të një padie dytësore mund ta shfrytëzojnë ndihmën e një avokati si mbështetës ose mund të përfaqësohen nga një i tillë, edhe para ngritjes së akuzës publike dhe pa deklarimin e një bashkimi. Ata kanë të drejtën e të qenit të pranishëm në seancën kryesore, edhe nëse të merren në pyetje së dëshmitarë. Edhe avokati i personit me të drejtën e padisë dytësore ka të drejtën e të qenit i pranishëm në seancën kryesore.

16. **Të drejtat e të plagosurit jashtë procedurës penale (neni 406j StPO (Kodi i Procedurës Penale i Gjermanisë)):**

- a) Në rastin e një pretendimi pasuror-juridik, i cili ka lindur nga vepra penale, i plagosuri, sipas neneve 403 - 406c StPO (Kodi i Procedurës Penale i Gjermanisë) dhe nenit 81 Ligji Gjyqësor i Gjermanisë i Adoleshentëve (JGG), mund ta parashtrojë atë kundër personit të akuzuar brenda procedurës penale, nëse ai i takon përgjegjësisë së gjykatave të rregullta dhe nëse akoma nuk është parashtruar pranë juridiksionit civil. Kërkesa përkatëse mund të parashtrohet me shkrim ose gojarisht për protokollimin e një nëpunësi protokollues, brenda seancës kryesore edhe gojarisht deri në fillimin e fjalëve të fundit. Ajo duhet të emërtojë arsyen dhe objektin e pretendimit dhe duhet të përmbajë mjetet provuese. Pas parashtrimit të një kërkesë, të plagosurit mund t'i miratohet ndihma e shpenzimeve procedurale për angazhimin e një avokati mbështetës.
- b) Veç kësaj, sipas përcaktimit
- të Ligjit të Mbrojtjes ndaj Dhunës (Gewaltschutzgesetz), i plagosuri mund të kërkojë lëshimin e urdhërimeve kundër të akuzuarit,
 - të Ligjit të Dëmshpërblimit të Viktimave (Opferentschädigungsgesetz), i plagosuri mund të parashtrojë një pretendim për mbajtje financiare dhe
 - të Udhëzimeve Administrative Federale ose të Landeve, i plagosuri eventualisht mund të parashtrojë pretendime dëmshpërblimi.
- c) I plagosuri gjithashtu mund të marrë mbështetje dhe ndihmë nga institucione të ndihmës së viktimave, si për shembull
- në formë të një këshillimi,
 - përmes vënies në dispozicion ose mundësimit të një vendstrehimi në një institucion mbrojtës ose
 - përmes mundësimit të ofertave terapeutike, si për shembull të ndihmës mjekësore ose psikologjike ose të ofertave të tjera mbështetëse të disponueshme në fushën psiko-sociale.

17. Të drejtat e të plagosurit brenda procedurës penale (neni 406i StPO (Kodi i Procedurës Penale i Gjermanisë)):

- a) Nën kushtet e neneve 395, 396 StPO (Kodi i Procedurës Penale i Gjermanisë) ose të nenit 80 par. 3 JGG (Ligji Gjyqësor i Gjermanisë i Adoleshentëve), i plagosuri mund të bashkohet me akuzën publike si paditës dytësor dhe në këtë,
- sipas nenit 397a StPO (Kodi i Procedurës Penale i Gjermanisë), ai mund të kërkojë bashkëngjitjen e urdhëruar të një avokati si mbështetje ose ndihmën e shpenzimeve procedurale për angazhimin e të njëjtit dhe,
 - sipas përcaktimit të nenit 397 par. 3 StPO (Kodi i Procedurës Penale i Gjermanisë) dhe të neneve 185 dhe 187 GVG (Ligji i Kushtetutës Gjyqësore i Gjermanisë), ai mund të parashtrojë një pretendim për përkthim me gojë dhe me shkrim brenda procedurës penale.
- b) Veç kësaj,
- i plagosuri mund të parashtrojë brenda procedurës penale një pretendim pasuror-ligjor i lindur nga vepra penale sipas përcaktimit të neneve 403 deri 406c StPO (Kodi i Procedurës Penale i Gjermanisë) dhe të nenit 81 JGG (Ligji Gjyqësor i Gjermanisë i Adoleshentëve),
 - përderisa ai merret në pyetje si dëshmitar nga prokuroria ose nga gjykata, i plagosuri mund të parashtrojë një pretendim për shpërblim sipas përcaktimit të Ligjit të Pagesave dhe të Shpërblimeve Juridike (Justizvergütungs- und -entschädigungsgesetz),

- sipas përcaktimit të nenit 155a StPO (Kodi i Procedurës Penale i Gjermanisë), i plagosuri mund të arrijë një dëmshpërblim në kuadër të një kompensimi mes aktorit dhe viktimës si dhe,
- sipas përcaktimit të nenit 158 StPO (Kodi i Procedurës Penale i Gjermanisë), i plagosuri mund të bëjë kallëzimin penal të një veprë penale ose mund të parashtrojë një kërkesë për ndjekje penale.

Paditës dytësorë tashme të aprovuar, nën kushtet e nenit 397a StPO (Kodi i Procedurës Penale i Gjermanisë), mund të kërkojnë bashkëngjitjen e urdhëruar të një avokati për padinë dytësore.

Të plagosur kanë mundësinë të marrin mbështetje dhe ndihmë gjithashtu përmes një institucioni të ndihmës së viktimave. Atje ata marrin gjithashtu informacione rreth shoqërimit psiko-social gjatë procesit.

18. Në Landin e Saksonisë së Ulët, viktimat të veprave penale ndër të tjerët kanë në dispozicion zyrtarët e ndihmës së viktimave të Fondacionit Ndihma e Viktimave e Saksonisë së Ulët (Opferhilfe Niedersachsen).

Zyrtarët e ndihmës së viktimave konkretisht ofrojnë këto shërbime mbështetëse: Përkujdesjen psiko-sociale dhe këshillimin, gjetjen e ofertave të mëtejshme të ndihmës dhe të këshillimit, shoqërimin në takimet e caktuara pranë gjykatës, pranë zyrave shtetërore, pranë avokatit dhe pranë mjekëve, si dhe mbështetjen në parashtrimin e kërkesave. Veç kësaj, viktimat marrin informacione rreth ndihmave dhe pretendimeve financiare.

Zyrtarët e ndihmës së viktimave i gjeni në këto qytete:

Aurich, Braunschweig, Bückeburg, Göttingen, Hannover, Hildesheim, Lüneburg, Oldenburg, Osnabrück, Stade dhe Verden. Zyrën në afërsinë tuaj me adresën, me personin kontaktues dhe me oraret e gjeni nën faqen e internetit www.opferhilfe.niedersachsen.de.

Fondacioni Ndihma e Viktimave e Saksonisë së Ulët (Opferhilfe Niedersachsen) ka një bashkëpunim të ngushtë me Zyrën e Landit të Saksonisë së Ulët të shoqatës WEISSER RING e.V. (Unaza e Bardhe, shoqatë e regjistruar) (www.weißer-ring.de). Veç kësaj ka shumë institucione të tjera të ndihmës së viktimave, të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në nivelin rajonal.

19. Informacione të mëtejshme gjinden gjithashtu në një broshurë të veçantë të Ministrisë Federale të Drejtësisë (Opferfibel (Abetarja e Viktimave)), të cilën mund ta shkarkoni nga interneti nën faqen <http://www.bmju.de/opferschutz>.
20. Për gjithë procedurën penale mund të shfrytëzohet angazhimi falas i një përkthyesë ose i një përkthyesi, nëse i plagosuri nuk zotën gjuhën gjermane ose nëse ai është me aftësi të kufizuara në dëgjim ose në të folurit. Veç kësaj mund të kërkohet përkthimi me shkrim i urdhërimeve të masave me heqje lirie si dhe i aktakuzave, i urdhërave për dënimin penal dhe i aktvendimeve jo të formës së prerë.